



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e VIII-të (tetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 23 shkurt 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:35.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, z.Selver Rama, dhe znj.Naile Ahmeti, ndërsa mungoi znj.Sevdije Mustafa,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete, dhe Kthim-Podujevë, dhe nga KFOR Rasztik Zita.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 25.01.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 09 dhjetor 2022

2. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, për punët dhe aktivitetet e Zyrës për periudhën qershor – dhjetor 2022

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, kemi këtë Informatë të ZKKK për çka e falënderoj shumë z.Liman Zeqirin – shef i kësaj Zyre, i cili është punëtor shumë i madh të cilin gjithherë e kemi pasë në përkrahje të Komuniteteve jo shumicë qoftë me sqarime, rregullim të dokumentacioneve dhe çështje tjera varësisht kërkesave të komuniteteve.

Gjithashtu falënderoj edhe Zyrën ligjore, zyrtarët e të cilës gjithherë kanë qenë në përkrahje të Komitetit për Komunitete qoftë me përgatitjen e dokumentacioneve të mbledhjeve, qoftë me

dhënie të sqarimeve dhe ndihmave të ndryshme për çështje të ndryshme ligjore që kanë të bëjnë me Komitetin për Komunitete.

Pra adresa e jona që kërkojmë ndihmë dhe që na ofrohet janë ZKKK dhe Zyra ligjore, të cilat në çdo kohë ofrojnë ndihmë për Komitetin për Komunitete dhe për pjesëtarët e komuniteteve në përgjithësi, kështu që për gjitha arritjet tona si Komitet për Komunitete meritat i takojnë ZKKK dhe zyrtarëve të Zyrës ligjore.

Fjalën i'a jap shefit të ZKKK, për paraqitjen e informatës sipas kësaj pike të rendit të ditës.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, e paraqiti Informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, fillimisht mund të them se për këto fjalë dhe lëvdata nga Kryesuesi mirëpo ne e kemi punë dhe obligim ligjor që të japim kontributet tona me gjitha mundësitë dhe kapacitetet tona e që ndoshta ndonjëherë nuk mund t'iu dalim në ndihmë aq sa kërkohet nga Komunitetet, por në këtë falënderim pa tjetër duhet të përfshihet edhe KFOR i cili gjithëherë ka qenë prezent dhe na ka ndihmuar në çështje të ndryshme që ndërliken me Komunitetet jo shumicë dhe jo vetëm.

Informatat që jepen nga ana jon si ZKKK natyrisht përshkruhen punët dhe aktivitetet e ZKKK-së që bënë në pikat dhe çështjet më kryesore që fokusohemi në bazë të punëve dhe detyrave që kemi në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe një të tillë e kemi bërë vazhdimisht dhe kuptohet edhe për periudhën janar – qershor 2022 edhe pse Komitetit për Komunitete është formuar në muajin qershor 2022 për shkak të disa vonesave që kanë qenë në themelimin e tij.

Si ZKKK jemi në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe çdo punë dhe aktivitete e bëjmë në koordinim me Kryetarin e Komunës, si dhe çdo herë kemi raporte javore tek Zyra e Kryetarit, po ashtu si ZKKK kemi edhe bashkëpunim dhe koordinim me gjitha Drejtoritë e Komunës, Kuvendin e Komunës, trupat e Kuvendit dhe shërbime tjera në kuadër të administratës komunale si dhe institucione tjera lokale dhe ndërkombëtare të sigurisë, pa përjashtuar edhe gjithë trupat dhe institucionet tjera që janë akter të Komuniteteve jo shumicë duke mos përjashtuar edhe çështje të ndryshme që ndërliken edhe me komunitetin shumicë ngase megjithatë jemi bashkëqytetarë. Gjithashtu bashkëpunim kemi edhe me Nivelin qendrorë duke filluar nga Zyra e Kryeministrit në kuadër të të cilës është një Zyrë e veçantë e cila merret me çështjet e komuniteteve dhe kthimin, pastaj me Ministrinë përkatëse për Komunitete dhe Kthim si dhe me Ministrinë dhe sektorët tjerë përkatës që janë në ndërlidhje me Komunitetet jo shumicë dhe çështjet e kthimit, sikurse që kemi bashkëpunim shumë të mirë edhe me shumë Organizata Joqeveritare qoftë vendore apo ndërkombëtare.

Megjithëse të gjithë e keni marrë me kohë informatën në fjalë dhe sigurisht keni mund ta lexoni dhe analizoni, unë nuk do të dëshiroja t'ju marrë shumë kohë, mirëpo megjithatë disa pika që janë në interes më të theksuar konsideroj se është mirë t'ju lexoj.

Po ashtu në kuadër të ZKKK kemi edhe zyrtaren për të drejtat e njeriut apo siç mund të quhet zyrtare kundër diskriminimit, e që çdokush mund të adresohet tek ne që mënon se është një e drejtë ligjore e që mund të mendoj se mund të ketë ndonjë diskriminim.

Në kuadër të kësaj ne kemi bashkëpunim edhe me akter tjerë shumë të rëndësishëm që na ndihmojnë shumë e që është OSBE dhe të tjera me të cilat kemi bashkëpunime të ndryshme dhe mbajmë takime të shumta në interes të përgjithshëm dhe me theks komuniteteve jo shumicë, e që kontributi i tyre është jashtëzakonshëm në përkrahje tonë, shtu këtu edhe persona që kanë ardhur nga vendet e konflikteve e të cilët kanë nacionalitete, kultura dhe etni të ndryshme e që edhe me këtë çështje jemi marrë në bashkëpunim me këto Organizata ku deri tani kemi pasë një familje të cilën pas disa përpjekjeve kemi arrit ta sistemojmë / strehojmë dhe tani është nën mbikëqyrjen e organeve përgjegjëse.

ZKKK ka takime të shpeshta dhe të rregullta edhe me Qendrën për Punë Sociale sepse jemi të interesuar edhe për gjendjen ekonomike, sociale, të punësimit dhe të tjera, dhe kur diskutojmë për këtë gjendje Komuna e Podujevës nuk është në një shkallë të kënaqshme dhe numri i atyre që kërkojnë asistencë social është në rritje e që 4013 banorë të komunitetit shumicë janë me këtë gjendje, pastaj nga komunitetet jo shumicë, 72 familje me 396 anëtarë të komunitetit ashkali, 5 familje të komunitetit rom me 36 anëtarë, pra kemi 77 familje të komuniteteve jo shumicë me 433 anëtarë dhe duke krahasuar këto shifra të komunitetit shumicë me ato të jo shumicë del një shifër prej 4445 anëtarë të familjeve që janë në asistencë sociale e që kohëve të fundit është në rritje si trend. ZKKK ka aktivitete të ndryshme edhe me Entin e Punësimit sepse papunësia është një problem në vete e dhe mund të themi se kjo çështje tek komuniteti jo shumicë është problem në vete andaj ne shpesh herë i'u sugjerojmë atyre që të regjistrohen në Entin e Punësimit sepse është problem për të ardhë deri te një vend i punës por megjithatë është mirë të kemi evidencë dhe shifra të sakta mirëpo edhe pse ka luhatje dhe në bazë të informatave që kemi për vitin 2022 janë 32 anëtarë të komuniteteve jo shumicë që janë të lajmëruar në Entin e Punësimit për të cilin çdoherë jemi mirënjohës për bashkëpunim.

ZKKK ka edhe takime dhe bashkëpunime tjera me Organizata të ndryshme siç është Caritas-i Zvicran i cili është i interesuar të na ndihmoj me projekte të ndryshme që janë në të mirë të qytetarëve neve si Komunë përmes bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit dhe në kuadër të kësaj ne kemi paraqitur një projekt për të cilin falënderoj edhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, pra kemi dorëzuar një projekt për një Inkubatorë i cili është i rëndësishëm për hapjen e bizneseve dhe zhvillimin e tyre në aspektin e përgatitjes profesionale dhe ta kenë si referencë në të ardhmen ata që merren me biznese si mundësi e së ardhmes për zhvillim ekonomik, projekt i cili parashihet të kushtoj rreth 50,000.00€.

Po ashtu ZKKK ka bashkëpunim me të gjitha Drejtoritë e Komunës po thuajse dhe varësisht natyrës çdoherë bashkëpunojmë ngushtë në funksion të ndihmave, investimeve dhe çështjeve të ndryshme që ndërlihen me familjet apo lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë, pra ne në mënyrë indirekte involvohemi për t'iu dalë në ndihmë atyre. Në këtë aspekt ne kemi pasë edhe një kërkesë nga Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për dërgimin e projekteve që ndërlihen me komunitetet jo shumicë e që ne kemi dërguar 3 projekte të cilat kanë rëndësi dhe duke bashkëpunuar edhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH por edhe Kompaninë e Ujësjellësit e cila na ka ndihmuar në projektin shumë të rëndësishëm që është rrjeti i ri i ujësjellësit në lagjen ku jetojnë familje të komuniteteve jo shumicë po edhe të shumicë në rr."Ali Ajeti" në të cilën kemi një rrjetë të vjetruar të ujësjellësit dhe në kuçedër të kësaj ne mendojmë se do të jetë shumë me rëndësi të bëhet rrjeti i ri i ujësjellësit duke ditë edhe rëndësinë e ujit të pijes, pra konsideroj se ky projekt ka kaluar dhe këtë vit do të realizohet, por që për këtë është premtuar edhe nga DSHPMSH.

Ndër aktivitetet tona si më të rëndësishme mund të them se kemi edhe në sektorin e arsimit si një prej shtyllave më kryesore e që ne kemi pasë një qasje jashtëzakonisht të mirë edhe me Drejtorinë e Arsimit, dhe gjithë këtë për qëllim që ta ndihmojmë arsimin sepse arsimit është ai që neve si shtet dhe shoqëri na qon përpara e që në këtë aspekt unë e kam thënë se, sa na duhet buka na duhet edhe dituria. Ne kemi marrë pjesë edhe në shumë module të ndryshme që ndërlihen me kapacitetet arsimore që kemi në Komunën e Podujevës që janë mbajtur nga Organizata të ndryshme dhe ligjërues të ndryshëm nga të cilët kemi marrë shumë informata dhe njohuri rreth arsimit në përgjithësi, për çka këto njohuri dhe informata i kemi transmetuar tek organet dhe njësitë përkatëse komunale, e që në këtë aspekt si Komunë nuk jemi keq por që kërkohet edhe angazhime dhe punë edhe më e madhe, andaj bazuar në këto rrethana mund të them se tek ata

fëmijë që kanë ngecje në arsim që janë me nevoja të veçanta apo edhe nga rrethana tjera do të angazhohemi të kem trajtime shtesë përmes moduleve për mësim shtesë apo aktivitete shtesë në funksion të zhvillimit të tyre, pra për këto si ZKKK kemi dhënë kontributet tona por edhe falë edhe bashkëpunimit me Organizatën IOM që kemi bërë implementimin e shumë projekteve në Komunën tonë përmes Memorandumeve të ndryshme e që buxhetin e aj kjo Organizatë e ka nga Zyra Evropiane por që implementimin e projekteve e bënë kjo Organizatë në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e që në vitin 2022 kemi arritur t'i sjellim fonde Komunën në shumë 42,028.00€, investime të cilat shumica prej tyre janë kabinete të ndryshme në shkolla të ndryshme dhe disa përmes bashkëfinancimit por që Komuna e Podujevës me shuma më të vogla, por që natyrisht se jemi edhe në proces të aktiviteteve tjera të rëndësishme që do të ndërmarrim në të ardhmen me Organizata të ndryshme dhe për këtë falënderojmë edhe Komunën e cila çdo herë ka qenë në funksion të participimit për projekte të ndryshme për çka jemi mirënjohës.

Për këto që i ceka, duhet falënderuar edhe Komunitetet jo shumicë dhe nxënësit e tyre që ta kemi një arsim më cilësor, mirëpo në këtë aspekt përfitues janë edhe nxënësit e komuniteteve shumicë falë kontributit të këtyre Organizatave të cilat ndihmojnë shkollat e ndryshme ku mësojnë nxënësit e të gjitha komuniteteve për çka natyrisht u jemi falënderues për ndihmën që po bëjnë me investime kapitale dhe investime në teknologji të re për shkollat e Komunës së Podujevës.

Natyrisht se ka edhe shumë aktivitete që kemi ndërmarrë dhe po t'i lexoj të gjitha ndoshta po ju marrë shumë kohë, por që ato më të rëndësishmet që janë nuk mund të mos përmend por që shumë shpejt ndoshta do të sjellim edhe një raport të veçantë.

Po ashtu ne merremi edhe me peronat e riatdhesuar të cilët kthehen nga shtetet tjera dhe kërkojnë informata dhe dokumente të ndryshme për çka ne vazhdimisht i ndihmojmë në shumë sfera dhe i drejtojmë në Entin e Punësimit ku pastaj dërgohen edhe në Qendrën e Aftësisimit Profesional dhe pastaj sërish kthehen tek ne që t'i ndihmojmë në rregullimin e dokumentacioneve për projektet e tyre që natyrisht pastaj kanë përfitime në ato projekte të cilat financohen kryesisht nga UNDP që ata persona të hapin biznese dhe ta rrisin biznesin e tyre në funksion të gjenerimit të të ardhurave të tyre dhe punësim. Në kuadër të kësaj ne kemi pas rreth 43 persona të cilët kanë themeluar biznese ku 35 prej tyre edhe kanë përfituar, e kjo falë edhe Drejtorisë së planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik e cila regjistrimin e bizneseve të tyre i bënë në procedurë më të shpejtë, por që këta persona përfitojnë edhe nga shumë Organizata tjera siç janë IOM, URA, Nyrnbergu etj të cilat merren enkas me këto çështje. Në vitin 2022 në Komunën e Podujevës janë kthyer 52 persona, 4 prej tyre janë të komunitetit ashkali, kurse 48 janë të komunitetit shumicë (prej tyre 4 janë nxënës) e që tek çështja e nxënësve është paksa e komplikuar mirëpo ka shumë prej tyre që duhet t'iu kthehet dokumentacioni shtesë sepse ka të tillë që kanë shkuar në klasën e II-të por që tani sërish duhet të kthehet dhe të filloj shkollimin nga ajo klasë, nëse me dokumentacion vërtetohet se ai nxënës ka vazhduar atë klasë në atë shtet ku ka qenë atëherë vazhdon nga klasa vijuese, pastaj ka raste që zhvillojnë mësim shtesë ngase kanë qenë për një kohë më të gjatë në shtetet tjera dhe normal që kanë harruar paksa gjuhën, pra ne si Zyrë i orientojmë dhe ju ndihmojmë në ato procedura që i'u nevojiten.

Ne si ZKKK jemi shumë e hapur për të gjitha rastet, procedurat dhe dokumentacionet e nevojshme që kërkohen që ndërliken me aktivitetet tona si Zyrë Komunale për Komunitete dhe Kthim, pra jemi në shërbim të komuniteteve dhe çdo herë do të punojmë dhe mundohemi me mundësitë dhe kapacitetet që kemi dhe jashtë tyre madje me të vetmin qëllim që t'iu dalim në ndihmë qytetarëve sepse ata kanë nevojë për shërbimet tona dhe ne jemi në shërbim të tyre.

Ne po ashtu kemi takime edhe KFOR për çështje të sigurisë dhe e falënderoj shumë për bashkëpunimin që kemi, dhe në këtë aspekt ne si Komunë duhet të jemi krenar në aspektin e

sigurisë sepse qe 24 vite nga paslufta jemi qetë dhe nuk ka kurrfarë eksesi ndëretnik apo diçka të ngjashme ngase ne bashkëpunojmë dhe bashkëjetojmë me gjitha komunitetet e që të gjithë janë të barabartë si çdo komunitet tjetër dhe në këtë aspekt jemi duke i ndihmuar dhe duke i'u dalë në ndihmë të gjitha komuniteteve për një stabilizim ekonomik për të gjitha ato familje që kanë nevojë. Pastaj një çështje e cila çdo herë na ka prekë si ZKKK është strehimi dhe banimi, megjithatë ne kemi hulumtuar dhe jemi munduar që edhe në këtë çështje t'i ndihmojmë edhe pse kjo është paksa më e ndërlikuar sa i përket çështjes pronësore sepse ne jemi në dijeni se shumica e komuniteteve jo shumicë kanë probleme pronësore, andaj duke u bazuar në këtë fillimisht duhet të vërtetohet se prona që duhet të jetë e tyre e pastaj të mundohemi t'i dalim në ndihmë qoftë nga Komuna qoftë nga donatorë të brendshëm dhe të jashtëm që kanë shprehë vullnet jashtëzakonisht të madh për t'i ndihmuar komunitetet jo shumicë, megjithatë duke falënderuar disa donatorë bamirës që tani është duke u ndërtuar kompleksi i shtëpive sociale në rrugën Podujevë – Dumnicë sigurisht se do ketë rastin që edhe nga komuniteti jo shumicë të jetë përfitues ndokush. Po ashtu për këtë çështje falënderoj edhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Sektorin e strehimit, Sektorin e banimit të cilat me disa ndihma të njëpasnjëshme ndihmon me strehim, me pako ushqimore, veshmbathje dhe gjësende të tjera atyre familjeve që kanë shumë nevojë, e që një familje (familja e Alush Bahtirit) e cila ka pasë shumë nevojë është transferuar në Lagjen e Dëshmorëve, e cila ka 23 anëtarë dhe që edhe përmes IOM është ndihmuar në forma dhe me gjësende të ndryshme ku një ndër ato kanë qenë edhe disa mjete pune vetëm e vetëm që ta ketë një gjendje sa më të mirë të mundshme dhe që brenda mundësive të zgjidhet çështja e strehimit për atë familje.

Çdo herë ne si ZKKK do të jemi me ju dhe do të bashkëpunojmë me ju si Komitet për Komunitete si dhe do të jemi të hapur që të gjitha punët dhe aktivitetet do të shqyrtojmë bashkërisht, në bazë të aftësive dhe mundësive tona që kemi për t'ju ndihmuar, andaj edhe pse pothuajse të gjitha i theksova sërish ju them se në qoftë se ndokush nga ju ka ndonjë vërejtje, sugjerim apo kërkesë për sqarime shtesë, urdhëroni unë jam këtu t'ju përgjigjem.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, falënderoj shefin e ZKKK për punën që bënë sepse vërtetë është punë voluminoze dhe këtë e them duke u bazuar në atë se ata që punojnë me komunitete kanë punë dhe angazhime të shumta, prandaj edhe këto që u paraqiten këtu janë shumë punë dhe informata të mira dhe kur shohim këto që i keni paraqitur në këtë informatë nganjëherë edhe vet mendoj si kemi mundur t'i bëjmë gjitha këto, prandaj ju falënderoj për të gjitha. Nëse ndokush ka diçka rreth informatës së ZKKK dhe z.Liman Zeqirit konkretisht, urdhëroni, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, paraqiti informatë rreth punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022, ndër të tjera theksoi, të gjithë jemi në dijeni rreth punës së këtij Komiteti edhe pse thuajse paksa me vonesë jemi formuar për disa shkaqe tash më të ditura.

Unë sërish e falënderoj Zyrën ligjore e cila ka dhënë kontribut dhe ndihmë në formimin e këtij Komiteti, qoftë në dokumentacione qoftë në aspekte tjera sa i përket formimit të këtij Komiteti.

Gjatë kësaj periudhe sa kemi funksionuar, unë dëshiroj të cekë vetëm disa punë që janë bërë nga Komiteti për Komunitete, kemi vizituar shkollat “Dr Ibrahim Rugova” “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri” ku kemi parë nga afër vijimin dhe zhvillimin e procesit mësimor të nxënësve të

komuniteteve jo shumicë, si qëndrojnë dhe ku ulen, a ka diskriminim ndaj nxënësve të komuniteteve e që ne jemi falënderues që jemi Komuna më e mirë sa i përket anës së arsimit, nxënësit e komuniteteve jo shumicë ulen bashkërisht në banka me nxënës të komunitetit shumicë, nuk ka dallime, lozin së bashku si dhe të gjitha që i kanë komuniteti shumicë i kanë edhe ai jo shumicë. Pastaj nxënësit e komunitetit jo shumicë regjistrohen pa kritere po thuajse në shkolla të mesme sepse në ato fillore është ndryshme regjistrimi i tyre, për çka falënderoj të gjithë drejtorët e shkollave të mesme, të cilët vazhdimisht na kanë përkrahë neve si komunitete jo shumicë e që të gjithë ata nxënës që janë lajmëruar në ato shkolla për tu regjistruar nuk kanë pasë pengesa por të gjithë janë regjistruar, vazhdojnë mësimin por edhe marrin bursa, për çka serish falënderoj shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri, për përgatitjen e dokumentacioneve për të gjithë nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe kemi arritur dhe që kemi arritur që me kohë të konkurrojmë për bursa e që sot ata marrin bursa.

Unë më shumë jam marrë me arsim dhe ajo që është më me rëndësi është se menjëherë pasluftës ne nuk kemi pasë nxënës në shkolla të mesme por që kemi arritur që për një kohë shumë të shkurtër ta zhvillojmë edhe këtë nivel dhe tani kemi shumë nxënës të regjistruar dhe që vazhdojnë shkollimin e nxënësve si dhe më e rëndësishmja është se nuk kemi braktisje të shkollimit. Problem ndoshta mund ta quajmë se pas shkollimit të mesëm, nxënësit e komuniteteve jo shumicë shumë pak shkojnë në fakultete dhe kjo krejt pothuajse për shkak të gjendjes ekonomike, kjo ndoshta edhe për shkak të udhëtimit në Prishtinë.

Ndër të tjera, këtu kemi pasë edhe disa drejtor të drejtorive, siç është Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorja e Arsimit, Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me të cilat kemi ngritur disa çështje, kemi marrë informata të ndryshme, kemi paraqitur kërkesat tona siç ka qenë ajo që kemi kërkuar që brenda mundësive të furnizohen me dru për ngrohje familjet e komuniteteve jo shumicë, mirëpo që na është sqaruar aspekti ligjor lidhur me këtë çështje edhe pse është provuar një gjë e tillë. Për arsim veç i potencova paraprakisht, kurse në shëndetësi mund të them se komunitetet jo shumicë nuk kemi probleme sa i përket aspektit të shëndetësisë qoftë me shërbime qoftë në aspekte tjera të kësaj natyre, pra as në këtë aspekt sikurse në aspektet tjera nuk jemi të diskriminuar, dhe këtë e them edhe nga përvoja ime sepse kam familjar të sëmurë dhe çdo të dytën natë pothuajse vizitoj spitalet e që asnjëherë nuk jam bërë i tepërt apo që të trajtohem ndryshe nga të tjerët.

72 familje të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, marrin asistencë sociale përmes Qendrës për Punës Sociale, por ka raste që nuk mund të marrin atë asistencë për shkaqe pronësore që është një mangësi shumë e madhe sepse ka raste ku dy vëllezër jetojnë në një shtëpi dhe njëri e merr socialin kurse tjetri jo. Sa i përket familjes së Alush Bahtirit e cila jetojnë tek hekurudha, dhe janë një familje shumë anëtarshme, jam angazhuar bukur shumë dhe një pjesë të asaj familje i kemi strehuar në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, mirëpo unë personalisht kam qenë i involvuar në një projekt ku një pjesë e asaj familje e kanë përfituar ndërtimin e një shtëpie por që nuk ka mund të realizohet për shkaqe të pengesave të ndryshme, kështu që tani ata janë shpërngulur në Fushë Kosovë, projekt i cili nuk është humbur dhe është shumë i mirë mirëpo mjetet financiare do të barten në Fushë Kosovë për ndërtimin e shtëpisë së asaj familje ngase ata e kanë blerë një pronë atje dhe do të ndërtohet një shtëpi, kështu që e them se problem i madh ka qenë strehimi i asaj familje sepse vërtetë kanë jetuar në një vende tepër të keq mirëpo me ndihmën e Zotit arritëm që atë familje ta ndihmojmë dhe t'ia zgjedhim përkohësisht çështjen e strehimit edhe pse jo ndoshta për kohë të gjatë, por në krahasim qysh ka qenë, tepër mirë është.

Në infrastrukturë mund të themi se rrugët ku jetojnë komunitetet jo shumicë shumica prej tyre janë ndërtuar dhe atë me kubza, për çka falënderoj Komunitetin kështu që ne kemi paraqitur kërkesat dhe ato rrugë që kanë qenë pa ndërtuar janë ndërtuar me kubza.

Çështje tjera pothuajse u potencuan edhe nga parafolësi z.Liman Zeqiri, mirëpo vlen të ceket se në rr.”Ali Ajeti” ku jetojnë familje të komunitetit jo shumicë, edhe pse ujë të pijes ka, ai ujë nuk mund të them se është i pijshëm ngase gypat janë të asbestit dhe janë kalbur, kështu që ujin e pijes e blejmë sepse ka qenë një organizatë e cila e ka bërë testimin e atij uji dhe ka dalë që nuk është të mirë, prandaj kjo është kërkesë që të ndërtohet rrejt i ri i ujësjes në atë lagje.

Pra kjo ishte sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, edhe pse z.Liman Zeqiri në pikën paraprake po thujse i përfshiu të gjitha. Prandaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës, dhe kalojmë në pikën e radhës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, është hapë një konkurs nga Njësia për kthim, kështu që kemi pasë probleme bukur të mëdha për nxjerrjen e dokumenteve sepse nuk kemi pasë printer. Unë kam kërkuar nga shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri, që ta marrim një printer në Komunë por që nuk ka pasë mundësi mirëpo zotëri Zeqiri bashkërisht me stafin e ZKKK ka arritur që për një orë të printoj / shtyp të gjitha dokumentet e nevojshme, dhe kemi arrite që komuniteti jo shumicë të arrijë të konkurroj për një kohë të shkurtër sepse afati ka qenë i tillë për projekte të ndryshme, për ndërtim të shtëpive, për rindërtim të tyre, për mobilim, për ushqim dhe shumë ndihma tjera, kështu që për këtë mund të themi se meritë kemi unë dhe shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri, por që e arritëm, prandaj falënderoj të gjithë për këtë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë e kam thënë edhe publikisht se ZKKK është enkas për komunitete dhe në këtë aspekt për çdo punë teknike, procedurale, dokumentacione dhe ndihma të ndryshme sipas nevojave, ne çdo herë jemi të gatshëm t’ju ndihmojmë me të gjitha kapacitetet që kemi, pra çdo herë do të jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve e në këtë rast edhe të komuniteteve jo shumicë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj juve z.Liman Zeqiri për çdo gjë. Gjithashtu edhe zyrtarin e Zyrës ligjore z.Enis Sheholli e falënderoj po ashtu i cili çdo herë na jap këshilla juridike dhe procedurale sa i përket çështjeve të ndryshme që ndërlidhen me Komitetin për Komunitete dhe jo vetëm, andaj nëse nuk ndokush të interesuar për të marrë fjalën, unë e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje dhe shihemi në mbledhjet e radhës.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0015233/23
Podujevë, 23 shkurt 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit
Xhafer Ademi**